



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E BRËNDSHME  
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Nr. 3427 Prot, datë 16. 06. 2011



REPUBLIKA E KOSOVËS  
MINISTRIA E PUNËVE TË BRËNDSHME  
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës

Nr. 586 Prot, datë 16. 06. 2011

## MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

PER

ORGANIZIMIN E SHËRBIMEVE TË PËRBASHKËTA TË POLICISË SË  
SHTETIT SHQIPTAR DHE POLICISË SË KOSOVËS,  
NË AKSET KRYESORE RRUGORE TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Policia e Shtetit Shqiptar, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm z.Hysni BURGAJ dhe Policia e Kosovës përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm z.Reshat MALIQI,

- të vetëdijshëm për nevojën dhe rëndësinë e bashkëpunimit mes dy agjencive policore në përpjekje për rritjen e elementëve të Sigurisë Rrugore;
- të ndërgjegjshëm për faktin se gjatë sezonit turistik Qershor – Shtator 2011, ka një rritje të ndjeshme të numrit të shtetasve nga Kosova që vijnë për pushime në zonat turistike të Shqipërisë, si dhe të mjeteve që qarkullojnë në akset kryesore rrugore që lidhin të dy vendet;
- me synim, intensifikimin e mëtejshëm të marrëdhënieve dhe për të forcuar bashkëpunimin midis policive të dy vendeve, nëpërmjet planifikimit dhe zbatimit të masave të përbashkëta;
- me qëllim, vendosjen e bashkëpunimit konkret në fushën e parandalimit të kundërvajtjeve administrative për rritjen e efikasitetit të luftës ndaj humbjes së jetëve njerëzore në aksidentet rrugore dhe zbatimin me rigorozitet të legjislacionit rrugor, për krijimin e një ambienti më të sigurt për të gjithë qytetarët dhe përdoruesit e rrugës, që qarkullojnë në akset rrugore që lidhin dy vendet ;
- me dëshirën për të mundur arritjen e synimeve të sipërpërmendura nëpërmjet një bashkëpunimi ndërinstytucional dhe ndërpoligor;
- bazuar në ligjin nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, Ligjin për Policinë nr. 03/L-035, i datës 20.02.2008 i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës;

bien dakord si më poshtë :

### **I. Detyrime të përbashkëta.**

1. Shërbimet e Policisë Rrugore të Policisë së Shtetit dhe të Policisë së Kosovës organizojnë patrullime të përbashkëta, për parandalimin e kundërvajtjeve administrative, kryesisht të atyre që janë burim aksidentesh dhe respektimin e normave të sjelljes, nga përdoruesit e rrugës.
2. Bashkëpunimi ndërmjet dy agjencive shtrihet në akset kryesore rrugore të Republikës së Shqipërisë.
3. Shërbimet e përbashkëta mes dy agjencive të policisë, kryhen me mjetet në përdorim nga shërbimet e Policisë Rrugore të Policisë së Shtetit Shqiptar dhe të Policisë së Kosovës.
4. Shërbimet e përbashkëta mes dy agjencive policore, organizohen e zbatohen sipas Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Shqiptar.

## II. Detyrime të Policisë së Shtetit Shqiptar.

1. Policia e Shtetit Shqiptar përgatit Urdhrin për planifikimin, organizimin dhe kryerjen e shërbimeve me patrullime të përbashkëta.
2. Policia e Shtetit Shqiptar mbulon shpenzimet për akomodimin, ushqimin dhe karburantin e shërbimeve të Policisë së Kosovës.

## III. Detyrime e Policisë së Kosovës.

1. Policia e Kosovës planifikon 12 (dymbëdhjetë) punonjës policie të trafikut dhe 6 (gjashtë) automjete shërbimi, për të kryer shërbime të përbashkëta me Policinë Rrugore të Policisë së Shtetit Shqiptar, në akset kryesore rrugore të Republikës së Shqipërisë.
2. Personeli policor të jetë i kompletuar me uniformë dhe pajisjet e nevojshme për kryerjen e shërbimit.

## IV. Të tjera.

1. Memorandumi i bashkëpunimit ndërmjet dy policive, shtrin efektet nga datë 17.06.2011 deri me datë 15.09.2011.
2. Në momentin e nënshkrimit të Memorandumit të Bashkëpunimit, nga palët nënshkruese lindin të drejta dhe detyrime të parashikuara në këtë Memorandum.
3. Memorandumi i bashkëpunimit ndërmjet dy policive, përpilohet në 4 (katër) kopje të njëjta dhe secila palë mban 2 (dy) kopje ekuivalente.
4. Ky Memorandum Bashkëpunimi hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

Nënshkruar në Tiranë, sot me datë 16. 06. 2011.

**Për Policinë Shtetit**

**Drejtori i Përgjithshëm**

**Hysni BURGAJ**



**Për Policinë e Kosovës**

**Drejtori i Përgjithshëm**

**Reshat MALIQI**

